



27 gusht 2024

Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për shtëpitë individuale të banimit THIRRJA E DYTË PUBLIKE

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, pas përfundimit të procedurave nga Thirrja e parë publike e datës 13 Gusht 2023, shpall Thirrjen e dytë Publike për zbatimin e projektit Emergjent “ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGIJË PËR SHTËPITË INDIVIDUALE TË BANIMIT” me qëllim të përmirësimit të kursimit të energjisë dhe rritjes së mirëqenies në shtëpitë individuale. Ky projekt mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA - Pako për Mbështetjen e Energjisë, i aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i zbatuar nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) fton pronarët e shtëpive që të shprehin interesin e tyre për të aplikuar për subvencionimin e masave të Eficiencës së Energjisë (EE) në shtëpitë e tyre në kuadër të këtij projekti.

Masat e Eficiencës së Energjisë përfshijnë:

- (a) Termoizolimimi i mureve të jashtme;
- (b) Termoizolimimi i kulmit; dhe
- (c) Ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme.

Specifikimi teknik i materialeve është dhënë në Shtojcën 1.

FKEE do të ofrojë një subvencion prej 45% të kostos së investimit, e kufizuar në shumën maksimale prej 5,500€¹, për zbatimin e masave të Eficiencës së Energjisë. Shuma e subvencionimit varet nga paramasa dhe parallogaria e aprovuar nga FKEE, për masat të cilat paraprakisht auditori i energjisë i ka konfirmuar në raportin e auditimit të thjeshtëzuar të energjisë².

Një bonus shtesë prej 5%, duke e rritur subvencionin në 50%, do të jepet nën rrethanat e mëposhtme:

- Nëse shtëpia është në bashkëpronësi të bashkëshortëve; ose
- Nëse gruaja është pronare e vetme e shtëpisë.

1. Kriteret e pranueshmërisë

Kriteret e pranueshmërisë për t'u kualifikuar për marrjen e subvencionit në përputhje me kërkesat dhe standardet të FKEE-së janë paraqitur më poshtë:

¹ Pavarësisht përqindjes 45% ose 50%, kufiri maksimal i subvencionit është 5,500 €. Shuma individuale e subvencionit llogaritet në bazë të sasive të verifikuara (nga kompania verifikuese) dhe kostove aktuale të bëra/paguara sipas faturës së detajuar dhe të paguar përmes transfertës bankare, duke mos tejkaluar çmimin e njësisë referente të përcaktuar nga FKEE

² Paramasa/parallogaria (PP) përfshinë çmimin për njësi për çdo masë të propozuar të Eficiencës së Energjisë. Çmimet referente përfaqësojnë koston për njësi që përfshijnë: materialet, instalimin/montimin, zëvendësimin, logjistikën dhe çdo punë tjetër të ndërlidhur me finalizimin dhe funksionalizimin e masave. Fatura e detajuar duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përshkruajë në mënyrë eksplicite çmimin për njësi të materialeve, sasinë, kostot e punës dhe shpenzimet logjistike siç specifikohet në PP.



Funded by
the European Union



FKEE
FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND



Republika e Kosovës
Republica Kosovo – Republic of Kosovo

1. Aplikuesi të jetë qytetar i Republikës së Kosovës dhe të ketë dokument identifikimi valid të Republikës së Kosovës;
2. Aplikuesi të jetë i regjistruar dhe i verifikuar në platformën eKosova - <https://ekosova.rks-gov.net/>.
3. Shtëpia³ të jetë e banuar dhe e lidhur me njërin nga distributorët operues energjetikë në Republikën e Kosovës;
4. Konsumi/pagesa për energji elektike:
 - 4a. 21 nga 24 muajt e fundit, shtëpia të ketë konsum të energjisë elektrike prej së paku 250 kWh (kilovat orë) për muaj⁴;
 - 4b. Kriteri sipas pikës 4a. nuk vlen për konsumatorët e rinj, të regjistruar⁵ nga data 1 shkurt 2024. Për konsumatorët e rinj kërkohet që të kenë një faturë të paguar të energjisë elektrike për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit. Verifikimi për pagesën e faturës së energjisë elektrike bëhet automatikisht nga e-Kosova⁶;
5. Të plotësohen kriteret teknike, si në vijim:
 1. Shtëpia të mos ketë izolim termik (të mureve të jashtme, të kulmit, dyer dhe dritare të vjetra/jocilësore);
 2. Në rastet kur aplikohet për ndërrimin e dritareve, dyerve apo për masa tjera, si izolimi i kulmit, atëherë shtëpia duhet të ketë izolim termik ekzistues në muret e jashtme me trashësi të izolimit së paku 8cm. Dritaret e kulmeve nuk përfshihen në subvencionimet e FKEE-së.

Aplikanti mund të zgjedhë një kombinim në mes masave të mundshme, por izolimi termik i mureve të jashtme mbetet kusht i detyrueshëm. Kjo nënkupton se nëse shtëpia nuk ka izolim termik (me trashësi të izolimit së paku 8cm) masat tjera nuk do të aprovohen fare.

Këto kërkesa janë në përputhje me Rregulloren MMPH nr.04/18 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave.

2. Paraqitja e aplikacionit përmes platformës online

Procesi i aplikimit përbëhet nga dy (2) hapa:

1. Plotësimi i aplikacionit në platformën online.
2. Bashkëngjitja e raportit të auditimit të thjeshtëzuar të energjisë. *Raporti duhet të jetë i hartuar pas datës së publikimit të kësaj shpalljeje.*

Platforma Online do t'ju lejojë plotësimin e Formularit të Aplikimit për Subvencionim.

Aplikanti mund të zgjedhë një auditor të energjisë nga lista ekzistuese e publikuar e auditorëve në faqen e internetit të FKEE-së:

<https://fkee-rks.net/download/lista-e-auditoreve-te-certifikuar-te-energjisë-divizioni-per-eficiencë-te->

³ Me termin "shtëpi individuale" nënkuptohet shtëpia e destinuar për banim (një ose më shumë kate) dhe shtëpia me përdorim të përzier (banim dhe tregtar) ku pjesa tregtare nuk kalon 50% të sipërfaqes totale, duke përjashtuar ndërtesat në bashkëpronësi-me shumë njësi banimi (shumë banesor). Në rastet e shtëpive dyshe/varg, aplikimi mund të bëhet individualisht, bazuar në orët e rrymës. Aplikimet për një njësi banimi të ndarë në kat brenda një ndërtese nuk do të konsiderohen.

⁴ Ky kriter vlen për aplikuesit, për të cilët verifikimi bëhet në formë automatike përmes e-Kosova (varësisht nga furnizuesi);

⁵ Me të regjistruar konsiderohen konsumatorët që figurojnë në bazën e të dhënave të furnizuesit të energjisë elektrike.

⁶ Në rast të pamundësisë teknike të verifikimit automatik në e-Kosova kërkohet të bashkëngjitet fatura e energjisë elektrike së bashku me dëshmi të pagesës për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit.



Funded by
the European Union



FKEE
FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND



Republika e Kosovës
Republica Kosova – Republic of Kosovo

[energjisë-2024/?wpdmdl=4242&refresh=66cd69f95d6da1724738041](https://fkee-rks.net/download/udhezuesi-per-aplikim-per-konsumatoret-qe-mund-te-verifikohen-automatikisht-ne-sistem/?wpdmdl=4242&refresh=66cd69f95d6da1724738041)

Auditori i energjisë mund ta ndihmojë aplikantin në përpilimin e aplikacionit përmes platformës online. Disa nga të dhënat nga raporti i auditimit të thjeshtëzuar të energjisë, përfshirë koston e masave potenciale, aplikanti do t'i vendos në mënyrë manuale në platformën e aplikimit.

Afati i përfundimit të punimeve dhe dorëzimi i kërkesës për disbursim është jo më vonë se 31 dhjetor 2024.

FKEE ofron shërbime edhe në zyrën e vet rajonale në Mitrovicën e Veriut për ndihmë ndaj qytetarëve për procesin e aplikimit.

Për udhëzime më të detajuara gjeni hapat e aplikimit në linqet:

Për aplikantët, të cilën MUND të bëjnë konfirmimin e konsumit të energjisë elektrike në mënyrë automatike-online (varësisht nga furnizuesi);, përmes e-Kosova -Linku: <https://fkee-rks.net/download/udhezuesi-per-aplikim-per-konsumatoret-qe-mund-te-verifikohen-automatikisht-ne-sistem/?wpdmdl=4235&refresh=66cd69f9158551724738041>

Për aplikantët, të cilët NUK MUND të bëjnë konfirmimin e konsumit të energjisë elektrike në mënyrë automatike-online (varësisht nga furnizuesi);përmes e-Kosova -Linku: <https://fkee-rks.net/download/udhezuesi-per-aplikim-per-konsumatoret-qe-nuk-mund-te-verifikohen-automatikisht-ne-sistem/?wpdmdl=4236&refresh=66cd69f920e161724738041>

!!! Aplikimet me raport të auditimit të thjeshtëzuar të energjisë do të trajtohen mbi bazën "kush vjen i pari, shërbehet i pari" për sa kohë që ka fonde të lira, andaj inkurajohen qytetarët të aplikojnë menjëherë sapo të hapet Thirrja, meqë e njëjta mund të mbyllet para afatit përfundimtar, në harmoni me buxhetin e dedikuar për këtë thirrje, i cili është 5 milionë euro.

Aplikanti mund të aplikojë vetëm për një shtëpi banimi. Pasi një aplikim të miratohet dhe të merret subvencioni, personat e njëjtë nuk kanë të drejtë të aplikojnë përsëri për subvencion nga FKEE.

Raporti i auditimit të thjeshtëzuar të energjisë në formë elektronike mund të shkarkohet në linkun <https://fkee-rks.net/thirrjet-publike/>, i cili duhet të bashkëngjiten në platformën e aplikimit elektronik përmes linkut ekosova.rks-gov.net/466.

3. Afati për aplikim

Afati i fundit për aplikim është deri më datën **10 shtator të vitit 2024** ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje.

Fondi ruan të drejtën që të mbyll afatin e aplikimit edhe para kësaj date, në rast se arrihet kuota e buxhetit në dispozicion.

Aplikacionet e dorëzuara pas kësaj date, aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së parakohshme për shkak të shpenzimit të buxhetit (nëse aplikohet) si dhe aplikacionet pa raport të auditimit të thjeshtëzuar të energjisë, nuk do të merren në shqyrtim nga FKEE.

Aplikimet e pranuar do të shqyrtohen bazuar në parimin “KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI” andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët.



4. Auditorët e Energjisë

Platforma Online do të përmbajë listën e auditorëve të energjisë (sipas listës zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë), duke e bërë më të lehtë gjetjen dhe angazhimin e tyre për aplikantët. FKEE nuk do të kompensojë auditorët drejtpërdrejt dhe nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim financiar ndaj tyre.

Auditorët e certifikuar të energjisë do të kryejnë inspektim të shtëpisë së aplikantit për të analizuar gjendjen ekzistuese dhe do të ofrojnë rekomandime për instalimin e masave të nevojshme të efikasitetit të energjisë.

FKEE do të kompensojë aplikantin për raportin e auditimit të thjeshtëzuar të energjisë me një shumë shtesë të subvencionit. Tarifa që do ta paguajë FKEE në emër të auditimit të energjisë, për përfituesit e grantit, është kufizuar deri në maksimum 150 Euro (njëqind e pesëdhjetë euro).

Një auditor i energjisë nuk pranohet të realizojë më shumë se njëzet (20) Auditime të thjeshtëzuara të energjisë përgjatë thirrjes. Shkelja e këtij kriteri nga ana e auditorëve dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga FKEE, mund të rezultojë me largimin nga lista e auditorëve dhe raportim në Ministrinë e Ekonomisë.

FKEE do të mbulojë kostot e Auditorit vetëm për kërkesat që përfundojnë me marrëveshje për disbursim.

Përmes nënshkrimit të Raportit të Auditimit të Thjeshtëzuar të Energjisë, Auditori konfirmon që do të kryej shërbimin duke respektuar Nenin 17-“Kodi i Mirësjelljes për Auditorët e Energjisë” të Rregullores Nr. 05/2020, dhe deklaron se ka vizituar fizikisht ndërtesën dhe ka aplikuar në përpikmëri kriteret e përcaktuara sipas rregullativës ligjore në fuqi dhe nga FKEE dhe se merr përgjegjësinë për saktësinë e matjeve dhe sasive të prezantuara për ndërtesën e trajtuar përmes këtij raporti.

Auditorët do të kryejnë shërbimin duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Sa i përket këtij projekti, auditorët e energjisë, nuk kanë të drejtë të bëjnë verifikimin e zbatimit të masave EE në shtëpitë individuale për të cilat kanë kryer auditimet e thjeshtëzuara të energjisë.

Nëse Raporti i auditimit të thjeshtëzuar të energjisë nuk është sipas kriterëve të paracaktuara, FKEE do të evidentojë Auditorin e Energjisë dhe kërkojë nga ME që të veprojë në harmoni me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2020.

5. Miratimi paraprak

Pas shqyrtimit dhe analizës së të dhënave të aplikantit, nëse i gjithë informacioni përputhet me atë që FKEE e ka paraparë si të nevojshme, FKEE, brenda dhjetë (10) ditësh, vendos për aprovimin e aplikacionit. Aplikantit i dërgohet një letër zyrtare - miratim paraprak, përmes postës elektronike, duke e informuar për miratimin e aplikacionit me masat e pranueshme. Kjo letër e miratimit paraprak nënshkruhet nga aplikanti dhe e skanuar i kthehet prapa FKEE-së brenda 3 (tri) ditëve pune, si shprehje e pajtimit me shkrim për kushtet dhe masat e aprovuara. Më pas, aplikanti brenda 3 (tri) ditësh do të marrë një konfirmim me e-mail se mund të fillojë me kryerjen e punimeve.



Republika e Kosovës
Republica Kosova – Republic of Kosovo

Afati maksimal për zbatimin e masave është deri më 31 dhjetor 2024, kohë brenda së cilës duhet të bëhet edhe kërkesa për disbursimin e subvencionit.

Miratimi paraprak (para-aprovimi) është një dokument ligjor që shpreh miratimin e kushtëzuar të masave dhe zotimin e FKEE-së për financimin e tyre të përcaktuara në formularin e para-aprovimit. Para-aprovimi do të shërbejë si bazë për verifikimin e masave EE që duhet të zbatohen nga përfituesi. Aplikanti mund ta përdor këtë para-aprovim së bashku me raportin e auditimit të thjeshtëzuar të energjisë dhe me paramasë dhe parallogari si referencë tek institucionet financiare lidhur me financimin e mundshëm me kredi të projektit deri në disbursimin e fondeve nga FKEE.

Aplikanti duhet të angazhojë kompaninë zbatuese të masave të EE vetëm në bazë të paramasës dhe parallogarisë së bashkëngjitur me dokumentin e para-aprovimit.

Shënim: Ju lutem vini re se asnjë grant nuk do të jepet në avans. Aplikanti duhet ta paguajë vet punëkryesin, ndërsa disbursimi i grantit do të bëhet vetëm pas pranimit të Raportit përfundimtar të Kompanisë Verifikuese.

Kompania verifikuese angazhohet nga FKEE, për të inspektuar nëse pas kryerjes së punimeve nga përfituesit, masat janë realizuar sipas kriterëve të FKEE-së dhe sipas paramasës dhe parallogarisë së bashkëngjitur me raportin e auditimit të thjeshtëzuar të energjisë dhe Para-Aprovimin. Në rast se kompania verifikuese dëshmon se aplikanti nuk ka plotësuar kriteret bazë të kësaj thirrjeje, FKEE rezervon të drejtën e anulimit të disbursimit edhe pas “para-aprovimit”. Kjo kompani angazhohet nga FKEE, për të kryer shërbimin për FKEE-në dhe aplikanti nuk merr përgjegjësi për pagesën e saj. Më detajisht roli i kompanisë verifikuese definohet në pikën 8 të kësaj Thirrjeje.

6. Ankesat

Nëse aplikanti nuk pajtohet me ndonjë vendim, ka të drejtë të paraqesë ankesë formale në FKEE sipas Formularit të Ankesës të publikuar në platformën elektronike në linkun: <https://fkee-rks.net/thirrjet-publike/>.

6 . Zbatimi i punimeve

Pronari i shtëpisë do të kontraktojë kompaninë punëkryese për të zbatuar Masat të Efiçencës së Energjisë. Punëkryesi duhet ta sigurojë aplikantin që puna kryhet nga një personel kompetent i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për secilin pozicion të punës, dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës sipas standardeve përkatëse teknike. Punimet kërkohen të përmbushin objektivin e përgjithshëm të investimit, duke u siguruar që materialet e instaluar të përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara në paramasë dhe parallogari.

Shënim: Aplikanti dhe punëkryesi sipas vullnetit të tyre mund të nënshkruajnë një marrëveshje ose profaturë për të zbatuar masat EE, duke përshkruar detajisht pozicionet që do të instalohen, sipas specifikave teknike të përcaktuara nga FKEE. FKEE nuk interferon në këtë marrëdhënie dhe nuk e obligon atë, por vetëm rekomandon lidhjen e saj.

7. Paraqitja e Kërkesës për Disbursimin e Subvencionit

Pas përfundimit të punimeve, pronari i shtëpisë (në tekstin e mëtejshëm 'përfituesi') njofton FKEE-në se ka përfunduar zbatimin e masave të aprovuara, dhe dorëzon formularin përkatës për disbursim të subvencionit.



Dokumentet e nevojshme për disbursimin e subvencionit:

1. Formulari për disbursim sipas formatit që mund shkarkohet në linkun: <https://fkee-rks.net/thirrjet-publike/>
2. Dokumenti i identifikimit- Letërnyoftimi/pasaporta;
3. Fatura e integruar të lëshuar me të gjitha pozicionet e detajuara të masave të EE të zbatuara, që korrespondojnë me materialet dhe sasitë e përmendura në paramasë dhe paralogari, si pjesë e bashkëngjitur e letres së para-aprovimit⁷;
4. Dëshmia e pagesës së Auditorit të Energjisë (faturë të rregullt dhe/ose transaksion bankar);
5. Dëshmia e transfertës bankare për të treguar se përfituesi ka paguar punëkryesin sipas faturës⁸; dhe
6. Konfirmimi nga banka me detajet e llogarisë bankare për përfituesin në emër të së cilit është Para-aprovimi.

Dokumentacioni i kompletuar me kërkesën për disbursim, dërgohet përmes emailit në adresën disbursimi@fkee-rks.net.

Dorëzimi i këtyre dokumenteve është thelbësor për të siguruar verifikimin e duhur të kërkesës për disbursim dhe në mungesë të ndonjërit dokument nuk mund të realizohet disbursimi.

SQARIM: Të gjithë përfituesit e subvencioneve për masat e Eficiencës së Energjisë lirohen nga pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Lirimi nga TVSH bëhet për tërë vlerën e projektit, pavarësisht vlerës së financuar nga Komisioni Evropian. Pra, të gjitha investimet lidhur me Projektin, në tërësi konsiderohen të lira nga pagesa e TVSH-së.

8. Verifikimi i Përfundimit/Mbikëqyrjes së punimeve

FKEE do të kontrakttojë kompani konsulente për të verifikuar nëse aplikanti ka përfunduar të gjitha masat e eficiencës së energjisë dhe ka përdorur sasitë dhe materialet e duhura së bashkë me çmimet referuese. Kompania do të përpilojë dhe dërgojë tek FKEE Raportin e Verifikimit për të vërtetuar se masat janë përfunduar dhe se aplikanti ka fituar të drejtën e disbursimit.

Ky raport do të përcaktojë nëse zbatimii masave është bërë në formë të pranueshme për rimbursim. Raporti përveç analizës teknike (inspektimi në terren nëse sasitë e masave të zbatuara (metrat katrorë të secilit pozicion⁹) janë sipas kriterëve të FKEE-së, paramasës e paralogarisë dhe raportit të auditimit të thjeshtëzuar të energjisë) bënë edhe analizën e dokumenteve financiare-faturave dhe transfereve bankare nëpërmjet bankës, në bazë të së cilëve i japin FKEE-së rekomandim për disbursimin e subvencionit.

Vëmendje: Kompania verifikuese, do të bëjë verifikimin e sasive të materialeve të implementuara, të cilat do të inspektohen dhe konfirmohen në terren dhe do të verifikohen të njëjtat në raport me sasitë e prezantuara në fatura, të cilat do të nënshkruhen nga përfituesit si dëshmi e pajtimit të tij me konstatimin. Verifikimi i zbatimit të masave të para-aprovuara do të bëhet nga ekipi i inxhinierëve të kompanisë.

Metodologjia inspektimit të zbatimit të masave EE është si vijon:

- Matjet gjatësore duhet të bëhen më metër laserik ose/dhe me shirit metër.
- Matjet e trashësisë së shtresës izoluese duhet të bëhen me penetrim/shpim me shufër metalike të shkallëzuar në njësi matëse centimetër.

⁷ Fatura e integruar nënkupton përfshirjen e materialeve dhe punës së kryer për masat përkatëse, p.sh.: një faturë për punët e izolimit termik, një faturë për dyer dhe dritare. Pra, të mos ndahen faturat për materialet dhe punën e dorës.

⁸ Asnjë pagesë pa transfertë bankare të rregullt nuk mund të pranohet për disbursim

⁹ Nëse një pozicion është realizuar nën kriteret e përcaktuara nga FKEE, ai nuk do të rimbursohet.



Funded by
the European Union



FKEE
FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND



Republika e Kosovës
Republica Kosova – Republic of Kosovo

- Verifikimi i dritareve duhet të bëhet me matjen e trashësisë së profilit me nonius ose shirit-metër, ndërsa xhamosja në formë vizuale. Vendosja e shtresës low-e duhet inspektuar me pajisje verifikuese adekuata.

Si përfundim, skicat e matjeve i prezantohen përfituesit. Nëse përfituesi pajtohet me rezultatet, skicat duhet të nënshkruhen nga ai.

Pas këtij procesi, në mes të përfituesit dhe FKEE-së do të nënshkruhet Marrëveshja për subvencionim, duke specifikuar shumën përfundimtare të subvencionit që do t'i transferohet përfituesit.

Komunikimi do të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës elektronike që aplikuesi ka prezantuar gjatë aplikimit në e-Kosova.

9. Marrëveshja e subvencionit dhe disbursimi

Disbursimi i subvencionit do të bëhet tek përfituesi pas nënshkrimit të Marrëveshjes për subvencionim. Shuma e subvencionit llogaritet bazuar në sasi të dhe kostot aktuale të verifikuara nga kompania verifikuese, ashtu siç parashikohet në faturën e detajuar dhe do të paguhet përmes transfertës bankare. Kjo shumë nuk do të tejkalojë çmimet referente për njësi për pozicione të vendosura nga FKEE si dhe tavanin e vendosur të subvencionit 5,500€ (pesë mijë e pesëqindë euro), plus shtesën prej maksimum 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) për raportin e auditimit të thjeshtëzuar të energjisë.

Marrëveshjet e subvencionimit do të nënshkruhen në zyrat e Postës së Kosovës dhe/apo në shtëpitë e përfituesve përmes shërbimit postar të Postës së Kosovës në gjitha adresat e përfituesve anëmbanë Republikës së Kosovës.

Brenda 30 ditësh, nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, të gjitha pagesat për përfituesin do të bëhen përmes transferit në numrin e llogarisë bankare të përfituesit (në Euro). Emri i aplikantit duhet të jetë saktësisht i njëjtë me emrin e përfituesit sipas Para-Aprovimit dhe llogarisë bankare.

Pasi FKEE të kryejë pagesën në llogarinë e caktuar të përfituesit, marrëveshja do të konsiderohet e përbushur nga FKEE.

10. Keqpërdorimi i fondeve

Në rast të çfarëdo lloji keqpërdorimi të fondeve ose mospërputhje me parimet e përcaktuara nga FKEE, përfituesi obligohet që shumën e rimbursuar/subvencionuar ta kthejë në llogarinë e FKEE-së brenda dhjetë (10) ditësh nga data e lëshimit të kërkesës për kthim. Sipas legjislacionit në fuqi, aplikanti do t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme ligjore.

11. Apeli i shumës së disbursimit të subvencionit

Nëse ju si përfitues nuk pajtoheni me vendimin përfundimtar të FKEE -se, ju mund të ankoheni dhe kërkonit të realizoni të drejtën tuaj para nënshkrimit të marrëveshjes.

FKEE do të krijojë një komision për vlerësimin e ankesave. Komisioni do të vlerësojë situatën në mënyrë të paanshme dhe do ta zgjidhë mosmarrëveshjen në mënyrë të drejtë.

12. Informatat tjera

Për më shumë informata, ju lutem drejtohuni Qendrës së thirrjeve:

- Për zyrën qendrore të FKEE-së në Prishtinë: 0800 222 70 ose përmes email-it në adresën:



Funded by
the European Union



FKEE
FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND



Republika e Kosovës
Republica Kosova – Republic of Kosovo

- thirrjapublike@fkee-rks.net, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri 16:00.
- Për zyren e FKEE-së në Mitrovicë të Veriut: 045 755 444 ose përmes email-it në adresën: thirrjapublike@fkee-rks.net, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri 16:00.

Shtojca 1. Specifikat teknike të pozicioneve

Përshkrimi i pozicionit	Specifikat teknike
Termoizolimi i mureve të jashtme	Termoizolimi i mureve të jashtme me EPS (stiropor), $t \geq 12$ cm,
Termoizolimi i mureve të cokullës	Termoizolimi i mureve të cokullës me XPS (stirodur), $t \geq 10$ cm, deri në lartësi $h \leq 40$ cm nga niveli i tokës;
Termoizolimi i konzolave (pallakat, ballkonet, streha e hyrjeve) ne kontakt me ajrin e jashtëm dhe i kornizës së kulmit	"Termoizolimi i konzolave (ballkonet, streha e hyrjeve apo zgjatimet tjera nga betoni) ne kontakt me ajrin e jashtëm dhe i kornizës së kulmit, me EPS $t \geq 5$ cm,
Ndërrimi i dritareve & dyerve të tarracës	Ndërrimi i dritareve të jashtme dhe dyerve të terracës/ballkoneve ekzistues me të rejtat nga PVC me këto karakteristika: - Korniza e profilit me trashësi se paku $b/h=80/80$ mm dhe min. 6 fusha termike dhe tre goma/dihtunga - Xhami i dyfishtë (së paku) $4+16+4$ mm, i mbushur me argon dhe xham Low "E" nga ana e brendshme dhe xham katërstinor nga ana e jashtme. - Mekanizmi mbyllës me kualitet të lartë - Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë, $U \leq 1.4$ W/m ² K
Ndërrimi i dyerve ekzistuese të Hyrjes	Ndërrimi i dyerve të hyrjes ekzistuese me të rejtat nga PVC me këto karakteristika: - Korniza e profilit me trashësi se paku $b/h=80/80$ mm dhe min. 6 fusha termike dhe tre goma/dihtunga - Xhami i dyfishtë (së paku) $4+16+4$ mm, i mbushur me argon dhe xham Low "E" nga ana e brendshme dhe xham katërstinor nga ana e jashtme. - Mekanizmi mbyllës me kualitet të lartë sipas DIN, EN, ISO - Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë, $U \leq 1.4$ W/m ² K - Rrip me furçë për mbrojtje nga moti - Cilindri i çelësit
Termoizolimi i kulmit të pjerrët - kulmi I ngrohte / qe shfrytëzohet	"Termoizolimi i kulmit ne pjesën e trajeve (pjesa e pjerrët e kulmit) me lesh guri, me trashësi $t \geq 15$ cm,
Termoizolimi i kulmit të pjerrët - i pllakës nen kulm / kulmi I ftohte	"Termoizolimi i pllakes nen kulm me lesh guri, me trashësi $t \geq 15$ cm
Termoizolimi i kulmit të rrafshët dhe i tarracës mbi hapësirën e ngrohur	" Termoizolimi i kulmit të rrafshët dhe i tarracës mbi hapësirën e ngrohur me XPS $t \geq 15$ cm,
Termoizolimi i mureve të atikës	"Termoizolimi i mureve të atikës EPS $t \geq 5$ cm,
Termoizolimi i tavanit të bodrumit	"Termoizolimi i tavanit të bodrumit me EPS $t \geq 12$ cm,
<i>Çdo material tjetër termoizolues i përdorur për termoizolim të pozicioneve Olartë duhet t'i përmbushë minimumin e karakteristikave termike: përçueshmëria termike λ sipas karakteristikave të përshkruara dhe me trashësi të njejtë (p.sh. për muret e jashtme nëse në vend të EPS përdoret lesh guri, duhet te ketë përçueshmëri termike $\lambda \leq 0.04$ W/mK, trashësia $t \geq 12$ cm)</i>	